

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168 /18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23 dhe 55/24), dhe në lidhje me nenin 92 paragrafët (1) dhe (3) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe pika 14 e Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-2679/1 datë 10.06.2024 dhe Konkluzionin ark.nr.02-3053/6 datë 18.07.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 29-të mbajtur më 17.07.2024, miratoi si në vijim:

Aktvendim për ndërmarrje të masës – vërejtje publike

1. PUBLIKTISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, për shkeljen e kryer të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), në atë mënyrë që transmetuesi në kuadër të shërbimit programor televiziv, më 28 maj 2024, nuk ka transmetuar të paktën 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, as nuk ka transmetuar të paktën gjysmën e minimumit ligjor program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, transmetuar në periudhën nga ora 7:00 deri në 19:00.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-2679/1 datë 10.06.2024, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi ta harmonizojë punën e saj me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita për miratim llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale me kërkesë, si dhe të paketave programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik nga aspekti i respektimit të dispozitave nga Ligji në fjalë, lejet, çertifikatat e dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe aktet tjera të miratuara nga Agjencia.

Në përputhje me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndërmerr masë - vërejtje publike në rastet kur ka shkelje ose cënim të dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe kushtet dhe detyrimet e përcaktuara me lejen dhe aktet tjera të Agjencisë.

Në pikën 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masave, përcaktohet se për shkeljet e konstatuara në vitin aktual, për të cilat janë shqiptuar masa në vitin paraprak, Këshilli i Agjencia sërish do t'u shqiptoi masë vërejtje publike sipas afateve të përcaktuara në Udhëzim.

Në bazë të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV, Shoqëritë Tregtare Radiodifuzive që transmetojnë shërbime programore televizive janë të detyruara të transmetojnë në ditë së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audio ose audiovizuale maqedonase, ndërsa shërbimi transmetues publik së paku 40%. Shoqëritë Tregtare Radiodifuzive që transmetojnë shërbim programor televiziv janë të detyruara të përmbushin së paku gjysmën e detyrimeve të përcaktuara në paragrafin (1) të këtij neni në periudhën prej orës 7:00 deri në ora 19:00.

Në kuadër të kompetencave të saj ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore, më 10 qershor 2024, ka kryer mbikëqyrje të kontrollit programor (monitorim), dhe ka konstatuar se më 28 maj 2024 shërbimi programor televiziv i SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, aspak nuk ka transmetuar program të

krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase dhe as nuk ka transmetuar së paku gjysmën e minimumit ligjor program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase në periudhën prej orës 7:00 deri në orën 19:00.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-2679/1 datë 10.06.2024, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë, me datë 11.06.2024, i dërgoi Shkresë me ark.nr.10-2679/2 datë 11.06.2024, me të cilën ka dorëzuar Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-2679/1 datë 10.06.2024, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimi të shkresës, t'i dorëzojë Këshillit të Agjencisë deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. E njëjta më 13.06.2024 dhe më datë 04.07.2024 është dorëzuar në formë elektronike në adresën elektronike zyrtare të transmetuesit e regjistruar si informacion kontaktues në RQRMV dhe në regjistrin e transmetuesve të udhëhequr nga Agjencia. Duke qenë se edhe pas dy tentimeve të kryera për pranimin e shkresës ark.nr.10-2679/1 datë 11.06.2024, drejtuar Agjencisë nuk ka ardhur letër kthyesë nga SH.A. Posta e RMV, Agjencia ka kryer kontroll në sistemin elektronik - ndjekjen e dërgesave të SH.A.Posta e RMV-së (përmes së cilës kontrollohet statusi i dërgesës), ku u konstatua se shkresa në fjalë ishte dorëzuar/adresuar në mënyrë të rregull transmetuesit më datë 27.06.2024. Në afatin e parashikuar, SHTR TRD TV GURRA SHPKNJP Kërçovë nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave të Ligjit. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 17.07.2024, pasi shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe konstatoi që SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë t'i shqiptohet masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht nga sa mësipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 nga LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 92 paragrafët (1) dhe (3) nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masave, Raporti me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-2679/1 datë 10.06.2024, për konstatim të mosrespektim të dispozitave të LSHMAAV, të përcaktuara në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 29-të mbajtur me 17.07.2024, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-3053/6 datë 18.07.2024, miratoi Aktvendim me të cilin publikisht paralajmërohet SHTR TV GURRA SHPKNJP Kërçovë dhe urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit, ta harmonizojë punën e saj me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 paragrafët (1) dhe (2) të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u mor vendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-2679/1 datë 10.06.2024.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga pranimi i aktvendimit.